

Forma e raportit

Raporti gjashtëmuor/vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm

Për periudhën prej 01.01 deri 31.12. 2019

I Pjesa e përgjithshme	
1. Të dhënat e përgjithshme për shfrytëzuesin e buxhetit (Subjektin e sektorit publik)	
Subjekti sektorit publik (SSP):	Komuna e Shtimes
Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik:	Dr.Naim Ismajli -Kryetar i Komunës
Emri dhe mbiemri i Drejtorit/ Auditorit të NjAB:	Fatmir Emini
Telefoni: 044-205-686	E-mail: fatmir.emini@rks-gov.net; fatmir_58@hotmail.com
Qëllimi i raportit gjashtëmuor/vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm: Raportimi tek Ministria e Financave - Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm lidhur me auditimet e kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm si dhe të dhënave të nevojshme për përpilimin e raportit unik (përmbledhës) gjashtëmuor/vjetor për sistemin e kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik.	
Roli dhe qëllimi i auditimit të brendshëm: “Auditimi i brendshëm” është veprimtari e pavarur me siguri objektive dhe këshillëdhënëse, për të shtuar vlerë dhe për të përmirësuar operacionet e organizatës. Ai ndihmon organizatën që të përmbush objektivat e saja, duke sjellë një qasje sistematike, të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efikasitetin e procesit të menaxhimit të rrezikut, kontrolleve dhe qeverisjes.	
2. Të dhënat për Njësinë e Auditimit të Brendshëm dhe auditorët e brendshëm	
2.1 Njësia e Auditimit të Brendshëm është themeluar sipas Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike	PO
2.2 Nëse përgjigja është JO – thekso arsyet	
2.3 Njësia e auditimi i brendshëm është themeluar sipas njërës nga mënyrat si në vijim: a) Njësi e pavarur të auditimit të brendshëm në vartësi të drejtpërdrejt të Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik; b) Njësi e përbashkët e auditimit të brendshëm sipas kritereve të përcaktuara nga Ministria e Financave; c) Nëpërmjet një marrëveshjeje për sigurimin e shërbimit të auditimit të brendshëm nga një subjekt i sektorit publik tek një tjetër, me miratimin paraprak të Ministrit të Financave; apo d) Nëpërmjet kontraktimit të një kompanie profesionale për kryerjen e auditimit të brendshëm, pas aprovimit të Ministrisë së Financave.	
2.4 Njësia e auditimit të brendshëm në mënyrë organizative i përgjigjet drejtpërsëdrejti dhe ekskluzivisht Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik	PO
2.5 Nëse përgjigja është JO – thekso kujt i përgjigjet dhe arsyet:	
2.6 A është plotësuar Njësia e Auditimit të Brendshëm sipas kërkesave ligjore	PO

Kërkesat minimale ligjore për numrin e auditorëve	Numri aktual i auditorëve	Burimet e nevojshme për auditim
2	2	2
2.7 Nëse përgjigja është JO - atëherë thekso arsyet për mos plotësimin e njësisë me numrin minimal të auditorëve sipas kërkesave ligjore: Prej muajit Qershor është bërë regrutimi edhe i një Auditori të Brendshëm.		
2.8 Drejtori i njësisë së auditimit të brendshëm dhe auditorët e brendshëm a janë të certifikuar sipas kushteve të parapara me ligj:		PO
2.9 Nëse përgjigja është JO thekso arsyet:		
2.10 Auditorët e brendshëm kryejnë vetëm punët e auditimit të brendshëm:		PO
2.11 Nëse përgjigja është JO - atëherë duhet theksuar cilat punë i kryen dhe cilat janë arsyet:		
2.12 Auditorët e brendshëm kanë qasje të plotë, të lirë dhe të pakufizuar te:		
a) Të gjithë dokumentacioni:		PO
b) Të dhënat dhe informatat tek të gjithë bartësit e të dhënave:		PO
c) Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik:		PO
d) Personeli (udhëheqësi dhe të punësuarit):		PO
e) Pasuria materiale:		PO
2.13 Nëse përgjigja është JO - duhet theksuar arsyet:		
Buxheti i subjektit të sektorit publik		
2.14 Paga dhe rogat		4,211,283.00
2.15 Mallra dhe shërbime		830,000.00
2.15.1 Shpenzimet komunale		199,068.00
2.16 Subvencione dhe transfere		131,766.00
2.17 Kapitale		1,885,868.00
Gjithsej buxheti		7,257,985.00
2.18 Njësia e auditimit të brendshëm ka buxhetin e ndarë		PO
2.19 Nëse përgjigja është PO - sa është buxheti i saj		
2.20 Nëse përgjigja është JO - në cilin departament është i vendosur buxheti i Njësisë së auditimit të brendshëm: NJAB funksionon si sektor në zyrën e Kryetarit (ZKA)-së. Buxheti për NJAB është i ndarë vetëm për paga.		
3. Zbatimi standardeve dhe metodologjisë së punës së Auditimit të Brendshëm		
Zbatimi i Doracakut të auditimit të brendshëm		
3.1 Auditorët e brendshëm kanë një ekzemplar të Doracakut të auditimit të brendshëm:		PO
3.2 Auditorët e brendshëm, përpos Doracakut të auditimit të brendshëm kanë edhe shtesën e vet të doracakut për auditim të brendshëm		JO
3.3 Nëse përgjigja është PO - a është kërkuar pëlqimi te NjQH/AB për shtesën e doracakut:		
3.4 Nëse përgjigja te pika 3.3 është JO - të theksohen arsyet		
3.5 Auditorët e brendshëm në kryerjen e auditimeve të veçanta/me kërkesë u përmbahen në tërësi fazave të proceseve të auditimit të përcaktuara me Doracakun e auditimit të brendshëm		PO
3.6 Nëse përgjigja është JO - theksoni arsyet:		
Statuti i auditimit të brendshëm		

3.7 Njësia e auditimit të brendshëm ka statutin e auditimit të brendshëm	PO					
3.8 Nëse përgjigjja është JO – theksoni arsyet:						
3.9 Statuti i auditimit të brendshëm është i nënshkruar nga Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe Drejtori i Njesisë së AB:	PO					
3.10 Nëse përgjigjja është Po – shkruaj datën e aprovimit të statudit	14.11.2019					
Zbatimi i kodit të etikës profesionale të AB						
3.11 Auditorët e brendshëm i përmbahen parimeve dhe rregullave të përcaktuara me Kodin e etikës profesionale:	PO					
3.12 Nëse përgjigjja është JO – theksoni arsyet dhe rastet e mos përmbajtjes:						
Kryerja e auditimit të brendshëm						
3.13 Plani strategjik i auditimit të brendshëm është përpiluar në bazë të vlerësimit të rrezikut:	PO					
3.14 Nëse përgjigjja është JO – theksoni arsyet:						
3.15 Planin strategjik të auditimit të brendshëm e ka miratuar Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe Komiteti i auditimit	PO					
3.16 Nëse përgjigjja është JO – theksoni arsyet:						
3.17 Plani vjetor i AB është hartuar në bazë të Planit strategjik të AB:	PO					
3.18 Nëse përgjigjja është JO – theksoni arsyet:						
3.19 Planin vjetor të AB të brendshëm e ka miratuar Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe Komiteti i auditimit:	PO					
3.20 Nëse përgjigjja është JO – theksoni arsyet:						
3.21 Subjekti i sektorit publik ka themeluar Komitetin e Auditimit	PO					
3.22 Nëse përgjigjja është JO – theksoni arsyet:						
Përgatitja dhe zbatimi i planit vjetor të auditimit të brendshëm						
3.23 Gjithsej numri i auditimeve të planifikuara me plan vjetor sipas periudhave raportuese dhe realizimi i tij (për të cilat janë përpiluar raportet finale)						
Periudha raportuese	Numri i auditimeve të planifikuara	Ditët e planifikuara për kryerjen e auditimit	Numri i auditorëve të planifikuar për angazhim	Numri i auditimeve të kryera	Koha e shpenzuar për kryerjen e auditimit	Numri i auditorëve të angazhuar për auditim
Gjashtëmujori I	3	85	1	3	85	1
Gjashtëmujori II	3	80	1	3	80	2
Vjetore	6	165	1	6	165	2
3.24 Arsyet për mos kryerjen e auditimeve sipas numrit të planifikuar të auditimit të brendshëm – theksoni arsyet:						
3.25 Auditimet e planifikuara dhe realizuar me kërkesë të Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik						
Numri i auditimeve të planifikuara me kërkesë	Ditët e planifikuar për kryerjen e auditimit	Numri i auditorëve të planifikuar për angazhim	Numri i auditimeve të realizuara	Koha shpenz. për auditimin me kërkesë	Numri i auditorëve të angazhuar	
-	-	-	-	-	-	

3.26 Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik i dërgohen raportet finale të auditimit menjëherë pas kryerjes së AB	PO
3.27 Nëse përgjigjja është JO – Theksoni si i dërgohen Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik raportet finale të auditimit: a) Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik i dërgohen të gjitha raportet e auditimit në fund të periudhës raportuese; b) Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik i dërgohen raportet e auditimit kohë pas kohe; c) Në mënyrë tjetër (theksoni si)-	
3.28 Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik përpilon dhe vendos për planin e veprimit i cili përfshinë rekomandimet e pranuar dhe veprimet të cilat duhet të ndërmerren në pajtim me ligjin për KBFP	PO
3.29 Nëse përgjigjja është JO – theksoni arsyet:	
3.30 Për rekomandimet e dhëna në raportet e auditimit njësia për auditimit të brendshëm ka bazën e organizuar të dhënave për zbatimin e rekomandimeve:	PO
3.31 Nëse përgjigjja është JO – theksoni arsyet:	
3.32 Rekomandimet e dhëna përcjellën sipas planit të veprimit, ashtu sikur është përcaktuar me doracak të auditimit të brendshëm.	PO
3.33 Nëse përgjigjja është JO – thekso arsyet:	
Numri i rekomandimeve në raportet e auditimit/planet e veprimit dhe numri i rekomandimeve të zbatuara në periudhën raportuese:	
3.34 Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit:	14
3.35 Numri i rekomandimeve të zbatuara:	6
3.36 Numri i rekomandimeve në proces:	4
3.37 Numri i rekomandimeve të pazbatuara:	4
3.38 Nëse ekzistojnë rekomandime të pazbatuara thekso arsyet e moszbatimit: Për disa Rekomandime kërkohet kohë,disa janë të lidhura me vitin fiskal.	
II Pjesa e veçantë	
1. Pasqyra e auditimeve të kryera dhe ndryshimi nga plani vjetor i auditimit, duke theksuar arsyet e ndryshimit ose moskryerjes së auditimeve të planifikuara	
Thekso të gjitha auditimet e kryera në periudhën raportuese me të gjeturat dhe rekomandimet, dhe drejtimi i shkurt për secilin auditim.	
1.1 Emërtimi i auditimit: Aktivitetet e zhvilluara në Zyren e prokurimit.	
Të gjeturat (përshkruaj të gjeturat) Sipas objektivave të Përcaktuara: 1.Planifikimi i Prokurimit: -Gjatë testimeve të bëra kemi konstatuar se Zyra e prokurimit ka përgatitur planin dinamik të prokurimit për përmbushjen e nevojave të domosdoshme dhe ka dorëzuar në APP,në përputhje të nenit 8 të LPP-së Nr04/L-042 dhe plotësimi i Ligjit 05/L-092 datë 19.02.2016. -Edhe pse ka përmirësim të konsiderueshëm,plani nuk është harmonizuar plotësisht me realizimin, ka devijime nga plani i prokurimit, gjegjësisht ka prokurime të pa planifikuara për vitin 2018.	

2.Procedurat e prokurimit:

- Zyra e prokurimit gjat procesit të prokurimit për vitin fiskal 2018 kryesisht ka zbatuar procedurat e prokurimit sipas Ligjit për prokurim publik në Kosovë Nr.04/L-042 , plotësimi i Ligjit 04/L-237 datë 17.04.2014,plotësimi iLigjit 05/L-068 datë 06.01.2016 dhe plotësimi i Ligjit 05/L-092 datë 01.03.2016.

2.1-Zbatimi i procedurave të prokurimit ;

Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimeve në Rr."Gashi" dhe "Tmava" në Godanc-Shtime (faza e dytë)

-Inicimi i i aktivitetit të prokurimit është bërë konform nenit 9 dhe 22 të Ligjit të PP Nr.04/L-042. Kërkesa për inicim të procedurës është bërë me datë 16.05.2018. Inicimi i i aktivitetit të prokurimit është bërë konform nenit 9 dhe 22 të Ligjit të PP Nr.04/L-042 dhe plotësimi i Ligjit 05/L-092 datë 16.05.2018.Deklarata e nevojave dhe disponushmërinë e fondeve të përgaditur nga Drejtori i Arësimit dhe ZKFdatë 16.05.2018.

-Shpallja e tenderit është bërë me datë 23.05.2018 afati për pranimin e ofertave 14.06.2018. Kriter për dhënje të kontratës ka qenë qmimi më i ulët dhe sigurimi i ekzekutimit 10%.

-Në tenderin e shpallur kanë konkurruar numer i mjaftueshëm i operatorëve ekonomik (5).

-Komisioni i vlerësimit e shpallë fitues operatorin ekonomik sipas kriterit çmimit më të ulët të ofertës. Datë:25.06.2018. Njohëtimi mbi dhënien e kontratës më 05.07.2018.Vlera e kontratës 60,735.59 €. Operatori fitues e tenderit ka garancion për sigurimin e ekzekutimit të punëve të paraparë në njohëtimin për kontratë të tenderit prej 10% e shprehur në vlerë absolute 6,073.56 €.

-Nënshkrimi i kontratës është bërë më 13.07.2018 .Vlera e kontratës 60,735.59 € .

-Data e fillimit të punëve ka qenë 16.07.2018 ndersa përfundimi i tyre40ditë pune sipas planit dinamik.

-Pranimi i punëve te kryera është bërë nga Komisioni për pranimin teknik të projektit me datë 05.09.2018.Pagesa e fundit është kryer me datë 19.09.2018 në vlerë prej 60,695.32 € .

2.2.-Zbatimi i procedurave të prokurimit ;

Projekti-Rregullimi i tretoareve, ndriqimi publik dhe gjelbërimi në rrugët "Adem Jashari" dhe "Komandant Kumanova"në Shtime –vazhdim i trasesë.

-Projekti është realizuar në bazë të memorandumit të mirëkuptimit dhe kntratës nr.18/2018 të lidhur me 04.05.2018 në mes së Komunës së Shtimes dhe Fondacionit Zvicëran për zhvillim dhe bashkëpunim DEMOS,për bashkëfinancimin e projektit.Vlera e vlerësuar e projektit do të jetë në vlerë prej 147,330.00 €. Financues të projektit do të jenë DEMOS me 68,410.00 € dhe Komuna e Shtimes me 78,920.00. Kërkesa për inicim të procedurës është bërë me datë 03.05.2018 -Inicimi i i aktivitetit të prokurimit është bërë konform nenit 9 dhe 22 të Ligjit të PP Nr.04/L-042 dhe plotësimi i Ligjit 05/L-092 datë 10.08.2018,deklarata e nevojave të domosdoshme dhe disponueshmërisë së fondeve është bërë nga personat kompetent më 10.08.2018.Ligji i Prokurimit publik Nr.04/042 neni 22 Inicimi i aktiviteti të prokurimit dhe plotësimi i Ligjit 05/L-092 datë 10.08.2018.Vlera e parashikuar e kontratës është paraparë të jete 147,330.00 €.

-Kontratë me vlerë të mesme.

-Shpallja e tenderit është bërë me datë 10.08.2018. afati për pranimin e ofertave 27.082018.Kriter për dhënje të kontratës ka qenë qmimi më i ulët dhe sigurimi i ekzekutimit 10%.

-Në tenderin e shpallur ka konkurruar 1 operator ekonomik.

-Komisioni i vlerësimit e shpallë fitues operatorin ekonomik sipas kriterit qmimi më i ulët . Datë:29.08.2018,vlera e kontratës 138,472.00 €. Njohëtimi mbi dhënien e kontratës më 13.09.2018.

Operatori fitues e tenderit ka garancion për sigurimin e ekzekutimit të punëve të paraparë në njohëtimin për kontratë të tenderit prej 10% e shprehur në vlerë absolute 13,847.20 € .

-Nënshkrimi i kontratës është bërë më 11.09.2018, nga Menaxheri i prokurimit. Vlera e kontratës 138,472.00 € .

-Data e fillimit të punëve ka qenë 11.09.2018 ndersa përfundimi i tyre më 14.12.2019. Njohtimi për nënshkrimin e kontratës datë 13.09.2018.

-Pranimi i punëve te kryera është bërë nga Komisioni për pranimin teknik të projektit me datë 11.12.2018.Pagesa e fundit është kryer me datë 19.12.2018 në vlerë prej 10,062.00 € nga pjesa e obligimit për Komunën .

Gjithësejt pagesat e Kryera janë në vlerë prej 138,472.00 € .

2.3.-Zbatimi i procedurave të prokurimit ;

-Projekti-Asfaltimi i rrugëve në brendi të fshatit Pjetërshticë.

-Inicimi i i aktivitetit të prokurimit është bërë konform nenit 9 dhe 22 të Ligjit të PP Nr.04/L-042 dhe plotësimi i Ligjit 05/L-092 datë 21.09.2018.Kërkesa për inicim të procedurës është bërë me datë 04.09.2018, deklarata e nevojave të domosdoshme dhe disponueshmërisë së fondeve është bërë nga personat kompetent më 21.09.2018.Ligji i Prokurimit publik Nr.04/042 neni 22 Inicimi i aktiviteti të prokurimit dhe plotësimi i Ligjit 05/L-092 datë 19.02.2016.Vlera e parashikuar e kontratës është paraparë të jete 30,000 € për vitin 2018,ndërsa 60,000.00 € për vitin 2019.

-Shpallja e tenderit(Njohtimi për kontratë)është bërë me 21.09.2019 afati për pranimin e kërkesave për dosjen e tenderit 04.10.2018.Kriter për dhënje të kontratës ka qenë qmimi më i ulët dhe siguri i ekzekutimit 10%.

-Në tenderin e shpallur kan konkurruar numer i mjaftueshëm i operatorëve ekonomik (4).

-Komisioni i vlerësimit e shpallë fitues operatorin ekonomik sipas kriterit qmimi më i ulët . Datë 08.10.2018. Njohëtimi mbi dhënien e kontratës më 22.10.2018.

Operatori fitues e tenderit ka garancion për sigurimin e ekzekutimit të punëve të paraparë në njohëtimin për kontratë të tenderit prej 10% e shprehur në vlerë absolute 6,814.40 € .

-Nënshkrimi i kontratës është bërë më 23.10.2018 nga Menaxheri i prokurimit. Vlera e kontratës 68,144.00 €.

-Data e fillimit të punëve ka qenë 23.10.2018 ndersa përfundimi i tyre më 23.10.2019.

2.4.-Zbatimi i procedurave të prokurimit ;

-Projekti-Asfaltimi i rrugëve “Zeqë Zeqiri” dhe “Sadriu” në fsh.Davidoc-Shtime.

-Inicimi i i aktivitetit të prokurimit është bërë konform nenit 9 dhe 22 të Ligjit të PP Nr.04/L-042 dhe plotësimi i Ligjit 05/L-092 datë 19.02.2016. Kërkesa për inicim të procedurës është bërë me datë 19.04.2018 deklarata e nevojave të domosdoshme dhe disponueshmërisë së fondeve është bërë nga personat kompetent më 02.05.2018.Ligji i Prokurimit publik Nr.04/042 neni 22 Inicimi i aktiviteti të prokurimit dhe plotësimi i Ligjit 05/L-092 datë 19.02.2016. Kontrata është kontratë me vlerë të mesme.

-Shpallja e tenderit(Njohtimi për kontratë)është bërë me datë 04.05.2018 afati për pranimin e kërkesave për dosjen e tenderit 28.05.2018.Kriter për dhënje të kontratës ka qenë qmimi më i ulët dhe siguri i ekzekutimit 10%,apo në vlerë prej 3,921.00 €.

-Në tenderin e shpallur kan konkurruar numer i mjaftueshëm i operatorëve ekonomik (6).

-Komisioni i vlerësimit e shpallë fitues operatorin ekonomik sipas kriterit qmimi më i ulët . Datë:04.06.2018,vlera e kontratës 39,210.00 € . Njohëtimi mbi dhënien e kontratës më 05.06.2018.

-Nënshkrimi i kontratës është bërë më , nga Menaxheri i prokurimit me datë 13.06.2018. Vlera e kontratës 39,210.00 € .

-Data e fillimit të punëve ka qenë 15.06.2018 ndersa përfundimi i tyre sipas planit dinamik 85 ditë pune, që dotë thot se operatori ekonomik ka pasur vonesa në kryerjen e punëve sipas planit dinamik.

Menaxheri i projektit i ka arsyatuar këto vonesë me arësyetim se projekti duhej të kalonte nëpër prona private, pronarët e këtyre parcelave kërkonin shpronësimin e këtyre pronave,për këtë arsye janë ndërprerë punimet deri sa pronarët e parcelave janë pajtuar që të asfaltohet rruga.

-Raporti mbi punimet e kryera nga Komisioni për pranimin teknik është bërë me 26.11.2018.

Pagesa e fundit është kryer me 13.12.2018.

3.Formimi i komisioneve:

-Në bazë të testeve të kryera konstatojmë se :

- ZKA ka bërë formimin e komisioneve për hapjen dhe vlerësimin e ofertave në bazë të LPP-së Nr4/L-042,plotësimi i Ligjit 05/L092 datë 19.02.2016,si dhe Udhëzuesit operativ për prokurimin publik .
- Ekzistojnë vendimet e marraura nga ZKA në bazë të nominimit nga menaxheri i prokurimit për emërimin komisioneve për hapjen e ofertave
- Ekzistojnë vendimet e marra nga ZKA në bazë të nominimit nga menaxheri i prokurimit për emërimin komisioneve për vlerësimin e ofertave .

Ekzistojn deklaratat e nënshkruara të anëtarëve të komisioneve nën betim.

4.Kontratat:

-Në bazë të testeve të kryera konstatojmë se :

- Në dosjet e prokurimit të cilat ishin pjesë e mostrave të cilat i kemi marrë për testim kemi konstatuar se kontratat janë dhënë në bazë të kriterit qmimit më të ulët ashtu siq janë paraparë edhe në tenderet e shpallura.
- Tenderuesit janë njohëtuar mbi kontratën e dhënë në përputhje me nenin 41 të LPP-së Nr4/L-042.

Nënshkrimi i kontratës është bërë nga Menaxheri i licencuar i prokurimit në përputhje me nenin 26 të LPP.NR.04/L-042 dhe plotësimi i Ligjit 05/L092 datë 19.02.2016.

5. Përshkrimi i vendeve të punës dhe trajnimet e stafit të prokurimit si dhe licencimi.

- Ekziston sistematizimi dhe përshkrimi i vendeve të punës.
- Sistematizimi i vendeve të punës është aprovuar nga KK me rastin e aprovimit të buxhetit për vitin 2018.
- Gjat vitit 2018 zyra e prokurimit ka pranuar edhe një zyrëtar shtesë i cili ende nuk ka ndjekur trajnimet dhe nuk është licensuar.Ndërsa Menaxheri i Prokurimit dhe stafi tjetër posedojnë licensën e nevojshme , neni 25 i ligjit LPP Nr.04/L-042 dhe plotësimi i Ligjit 05/L-092 datë 19.02.2016.
- Me datë 22.02.2018 zyrëtarja e prokurimit (e licensuar) është caktuar ushtruese e detyrës: Udhëheqëse e zyrës së prokurimit deri në përzgjedhjen e udhëheqësit të ri përmes të procedurave të rregullta të regrutimit.

Rekomandimet :(përshkruaj rekomandimet, të cilat kanë të bëjnë me të gjeturat e përshkruara)

Rekomandimi nr.1

Edhe pse ka përmirësim të konsiderueshëm në hartimin dhe zbatimin e planit të prokurimit ne rekomandojmë që gjatë përpilimit të planit dinamik të prokurimit, të merren parasysh zërat buxhetor, të planifikohet në pajtim me prioritetet e nevojave të domosdoshme të Komunës,dhe gjatë ekzekutimit të i përmbahet këtijë plani.

Rekomandimi Nr.2.

Rekomandojmë menaxhmentin që në të ardhmen gjatë shpalljes së tendereve të specifikohen qartë rrugët apo segmentet rrugore sipas emërtimeve të tyre e sidomos të behet paramasa dhe paralogaria për sejcilin segment të këtyre rrugëve .

Rekomandimi Nr.3.

Me qëllim të shmangjes së vonesave gjatë implementimit të kontratave dhe evitimit të penaleve qoftë nga kontraktuesi apo operatori ekonomik ,gjatë hartimit të projektit të bëhet identifikimi i pronësisë së pronave dhe rregullimi i tyre.

Rekomandimi Nr.4.

Ne rekomandojmë që sa më parë të zgjidhet udhëheqësi i zyrës së prokurimit.Pashtu zyrëtar i regruatuar gjatë vitit 2018 të i ndjek trajnimet dhe të merr licensen për zyrëtar të prokurimit.

Përmbajtja e shkurt drejtuese (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):

2. FUSHËVEPRIMI DHE OBJEKTIVAT E AUDITIMIT

2.1-Objektivat e Auditimit: Për të siguruar se:

- Ka një plan vjetor të prokurimit;
- Zbatohen procedurat e prokurimit në bazë të Ligjit për prokurim publik në Kosovë Nr.04/L-042 ,plotësimi i Ligjit 04/L-237 datë 17.04.2014,plotësimi iLigjit 05/L-068 datë 06.01.2016 dhe plotësimi i Ligjit 05/L-092 datë 01.03.2016.
- Vendimet për formimin e komisioneve;
- Kontratat për punët e kontraktuara;
- Përshkrimi i vendeve të punës dhe trajnimet e stafit të prokurimit si dhe licensimi.

2.2 Fushëveprimi i auditimit

Zyra e prokurimit Komuna –Shtime

Periudha : Prej 01.01 deri më 31.12 2018.

1.2 Emërtimi i auditimit: Menaxhimi i pasurisë

Të gjeturat:

Të gjeturat kryesore janë paraqitur në vazhdim:

1. Pprocedurat e menaxhimit të pasurisë.

- Gjatë rishikimit dhe testimeve të bëra ne gjetëm se :
- Ekzistojnë procedurat për menaxhimin pasurisë konform Ligjit mbi mnaxhimin e financave publike Nr.03./L-48 Ligji mbi menaxhimin e financave të pushtetit lokal 03/L-49 dhe Rregullorja e MF për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore

Nr.02/2013.

-Në përgjithësi zbatohen procedurat e përcaktuara.

2. Evidentimi i rregullt i pasurisë së blerë.

-Ekziston regjistri kryesor i regjistrimit të pasurisë.

-Regjistri i pasurisë i plotëson kërkesat mbi të dhënat e parapara.Por sipas Rregullores së MF për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore Nr.02/2013 parashihet që për pasuritë jo kapitale në vlerë nën 1000 € me afat përdorimi mbi një vit dhe stoqet të përdoren regjistrat kontabël "e pasuria".

- Pasuritë në vlerë mbi 1000 € regjistrohen në free balanc ndersa ato nën 1000 € deri në vitin 2017 janë të regjistruara në regjistrin e brendshëm të pasurisë.Ndërsa blerjet e reja gjatë vitit 2018 janë regjistruar në regjistrin kontabël "e pasuria" të paraparë me nenin 6, të rregullores 02/2013,kurse pasuritë e trashëguara, donacionet dhe blerjet e më hershme ende nuk janë të regjistruara në regjistrin kontabël "e" pasuria",pasi që zyrëtarët e Komunës nuk kanë qasje për ta bërë bartjen e këtyre aseteve në këtë regjistrë.

3. Inventarizimi vjetor i pasurisë.

-Komisioni për regjistrimin e pasurisë është formuar në bazë të Rregullores së MF për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore me vendim të Kryetarit të Komunës Nr.02/613 të datës 06.11.2018 Komisionet jane formuar për të gjitha Institucionet:Administratë Komunale,shëndetësi,mirëqenje sociale,Arësim ,njëherit është formuar edhe komisioni për vlerësimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore vendimi nr.02/614 të datës 06.11.2018,Rregullorja Nr.02/2013.

-Komisioni për regjistrimin e pasurisë, ka kryer inventarizimin e pasurisë në të gjitha njësitet buxhetore .

-Komisioni për regjistrim në njësitet buxhetore ku është kryer inventarizimi ka kryer regjistrimin edhe të pasurisë të pa përdorur dhe ka dhënë propozim për qitje jashtë përdorimit të kësaj pasurie si dhe i janë dërguar Komisionit të vlerësimit të pasurisë që të vlerësohen dhe të i dërgohen Zyrës së prokurimit për hapjen e procedurave të shitjes. Komisioni për vlerësimin e pasurise ende nuk e ka kryer vlerësimin e pasurisë në përdorim e që nuk ka vlerë financiare.

-Në evidencën e regjistrit kryesor janë të evidentuar personat përgjegjës për ruajtjen dhe shfrytëzimin zyrtar të pasurisë dhe këta regjistra janë të vendosur në zyret e personave përgjegjës . Këta regjistra jo gjithmonë përputhen me gjendjen faktike pasi që ka lëvizje të konsiderueshme të paisjeve nga zyra në zyrë pa lajmërim të zyrtarit për menaxhimin e pasurisë dhe pa bartjen formale dhe regjistrimin e ndryshimeve në regjistrin kryesor të pasurisë .Këto ndryshime janë konstatuar nga Komisioni i inventarizimit vjetor të pasurisë për vitin 2018 si dhe nga testimet e bëra nga Auditori i Brendshëm.Kjo dukuri përseritet edhe nga viet e kaluara edhe pse auditori i brendshëm për këto parregullësi ka dhënë rekomandim në raportin për vitin 2017.Nuk ka kujdes te mjaftueshem për ruajtjen e barkodeve te vendosura ne asetet.

4. Zbatimi i procedurave të barazimit.

-Gjatë testimit se a ka barazim në mes të evidencës së pasurisë sipas evidencës kontabël dhe inventarizimit vjetor të komisioneve për inventarizim të pasurisë nën 1000 € zyrëtarit për menaxhimin e pasurisë ka vështërsi të bëjë barazimin në mes të regjistrimit vjetor të komisionit për inventarizim dhe regjistrit të pasurisë për shkak të lëvizjes të pa autorizuar të pasurisë dhe pa respektimin e procedurave, gje që i bënë të pa mundur zyrtarit të pasurisë barazimin sipas personave përgjegjës.

Rekomandimet:**Rekomandimi Nr.1**

Edhe pse Komuna ka një regjistër të pasurisë i cili i plotëson kërkesat mbi të dhënat e parapara, ne rekomandojmë menaxhmentin që pasurinë nën 1000 € ta regjistrojë në modulën “e pasuria” të paraparë me rregulloren Financiare 02/2013.

Rekomandimi Nr.2

Ne rekomandojmë Menaxhmentit që me rastin ngarkesës së zyrtarëve përgjegjës, pranimi dhe lëvizjes së paisjeve në lokale tjera , gjegjësisht pranim dorëzimin e tyre të kryhet në prezencë të zyrtarit të menaxhimit të pasurisë duke pëdorur procedurat e parapara (përdorimi i formularëve).Çdo lëvizje jo formale dhe pa pranimë e zyrtarit të menagjimit të pasurisë të trajtohet si shkelje e procedurës dhe shfrytëzim i pa autorizuar.

Rekomandimi Nr.3

Meqenëse anëtarët e komisioneve për rexhistrimin e pasurisë ndërrohen vit pas viti dhe mund të jenë jo profesional, me qëllim të rritjes së kualitetit të punës së komisioneve Drejtoria me rastin e regjistrimit vjetor të pasurisë të organizoj një trajnim për anëtarët e komisioneve për regjistrimin dhe vlerësimin e pasurisë.

Përmbajtja e shkurt e drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):

2. FUSHËVEPRIMI DHE OBJEKTIVAT E AUDITIMIT

2.1 Objektivat e auditimit ishin: Për të rishikuar sistemin e kontrollit të brendshëm të menagjimit të pasurisë dhe për të dhënë siguri të arsyeshme se:

- 1.1. Procedurat e menaxhimit të pasurisë janë themeluar si duhet ,konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.
- 1.2. Që të ketë procedura të barazimit ,të ketë gjurmë,dhe janë të miratuara nga niveli i duhur i menaxhmentit.
2. Të ipet një opinion për përshtatshmërinë dhe efikasitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
3. Të ipen rekomandime për përmirësimin nëse ka nevojë dhe për të siguruar se është arritë marrëveshje për to.

2.2 Fushëveprimi i auditimit

-Rishikimi i menagjimit të pasurisë për vitin 2018.

1.3 Emërtimi i auditimit: Shpenzimet për mallra dhe shërbime në Drejtorinë për arësim

Të gjeturat:

Objektivat kryesore të këti auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut lidhur me proceset e shpenzimit të Mallrave e shërbimeve për të siguruar se:

- Ka plan dinamik të shpenzimeve;
- Shpenzimet realizohen sipas planit;
- Mallrat pranohen nga zyrtari për pranimin e mallrave dhe shërbimeve,si dhe mbanë evidencë për to;
- Barazimet;

-Testimi është bërë në përcjellje të planit dinamik të shpenzimeve dhe realizimeve të nevojave të domosdoshme. Nga rishikimet e bëra është vërejtur se në përgjithësi drejtoria e arësimit ka implementuar procedurat në pajtim me legjislacionin në fuqi, por ka hapësirë për përmirësime të matutjeshme në të ardhmen.

Të gjeturat kryesore sipas objektivave janë paraqitur në vazhdim:

3.1.1.-Ka plan dinamik të shpenzimeve;

-Drejtoria ka përgatitur planin dinamik të shpenzimeve për mallra dhe shërbime për përmbushjen e nevojave të domosdoshme.

-Plani nuk është harmonizuar me realizimin, gjegjësisht ka devijime nga plani i shpenzimeve.

Sipas raportit të analizave financiare dhe testeve të kryera është vërejtë se ka mospërputhje të nënshpenzimeve të planifikuara dhe të realizuara.

3.1.2.-Shpenzimet realizohen sipas planit dhe buxheti të aprovuar;

-Ne gjetëm se shpenzimet e planifikuara për vitin buxhetor 2019 ishin 199,337.00 € ndërsa për periodhën prej 01.01 deri më 31.05 2019 kanë qenë 83,057.08 kurse shpenzimet e realizuara për këtë periudhë janë 26,169.90, e shprehur në përqindje 31.51%.

-Ndër shpenzimet e pa planifikuara janë ato për pagesat për pagat jubilarë dhe përcjellëse për punëtorë të cilët dalin në pension në vlerë prej 8,070.00 €, apo 30.84 % nga të gjitha shpenzimet e realizuara për M&SH.

-Këto shpenzime të pagura për këtë destinim nuk janë paguar nga byxheti i njësive buxhetore (shkollat) nga të cilët janë punëtorët që janë kryer këto pagesa, gjë që do të ndikoj në mungesën e plotësimit të nevojave të domosdoshme dhe realizimit të shpenzimeve të planifikuara sipas buxhetit të këtyre shkollave nga të cilat janë kryer këto pagesa.

-Rrjedhimisht, nuk ka siguri të mjaftueshme dhe kontrollë të plotë në pikpamjen e sigurimit të menaxhmentit se paratë janë përdorur për atë çka janë parashikuar me planifikimin buxhetor.

3.1.3.-Pranimi i mallrave bëhet nga zyrtari për pranimin e mallrave.

-Pranimi i mallrave bëhet nga zyrtari për pranimin e mallrave.

-Komuna ka një depo vend të caktuar për deponimin e mallrave të pranuar nga zyrtari kompetent.

-Zyrtari për pranimin e mallrave ka një evidencë për pranimin dhe shpenzimin e mallrave në shtetverin "e pasuria".

-Komisioni për inventarizim vjetor nuk e ka kryer inventarizimin e stokeve të mallrave në depo më 31.12.2018.

3.1.4. - Barazimet;

-Nuk kemi mundur të konstatojmë se bëhet barazimi në mes të stokeve të mallrave sipas librave dhe regjistrimit të mallrave në stoke pasi që nuk është kryer regjistrimi i këtyre stokeve më gjendje 31.12.2018.

Rekomandimi Nr.1.

-Ne rekomandojmë drejtorinë që të përcjellë zbatimin e procedurave për lëvizjen e shpenzimeve dhe nënshpenzimeve në zërat buxhetor (me rastin e rishikimit 6 mujor të buxhetit) që këto të realizohen sipas planit dhe disponueshmërisë së fondeve. Kjo do të sigurojë respektimin e zërave të aprovuar buxhetor, duke realizuar shpenzimet sipas destinimit të përcaktuar me plan dhe buxhet.

Rekomandimi Nr.2.

Ne rekomandojmë menaxhmentin që gjatë hartimit të buxhetit të bëjë planifikimin e buxhetit për pagesat për pagat jubilarë dhe përcjellëse për punëoret të cilë shkojnë në pension.

Rekomandimi Nr.3

Me qëllim të verifikimit të stokeve të mbetura të bëhet regjistrimi i stokeve në depo me gjendje 31.12 të çdo viti fiskal.

Përshkrimi i shkurt i drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):

2.OBJEKTIVAT DHE FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT**2.1 Objektivat kryesore të këtijë auditimi janë për të siguruar se:**

- Ka plan dinamik të shpenzimeve;
- Shpenzimet realizohen sipas planifikimit të buxhetit për vitin 2019;
- Mallrat pranohen nga zyrtari për pranimin e mallrave dhe shërbimeve, si dhe mbanë evidencë për to;

2.2 Fushëveprimi i auditimit

Drejtoria për arsim -Shtime

Mallrat & shërbimet-periudha:Prej 01.01 deri me:31.05. 2019.

1.4 Emërtimi i auditimit: Të hyrat vetanake nga tatimi në pronë.

Të gjeturat:

Të gjeturat kryesore sipas objektivave të caktuara të të paraqitura në këtë raport janë :

1. -Për të siguruar se njësia e TP ka krijuar bazën e vlerësimit të dhënave të TP;

-Gjat intervistave të kryera me stafin e zyrës së TP si dhe gjat testimeve të kryera kemi konstatuar se ekziston bashkëpunimi me Drejtorinë e Urbanizmit dhe kadastrit.Por ky bashkëpunim duhet të intensifikohet edhe më shumë pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri Nr.06/L-005 për TP mbi pronat e pa luajtshme-parcelat .

-Regjistrimi i pronave është kryer nga ana e anketuesve në bazë të vizitave në teren.Gjat vitit 2019 janë regjistruar 31 prona të reja .

-Me rastin e testimeve kemi hasur në raste ku është bërë regjistrimi i obliguesit të TP për pronën e pa luajtshme objektin ndertimor ndersa për pronen rezidenciale parcelen, nuk është bërë regjistrimi.

2.- Objektivi:2.-Për të siguruar se njësia e TP ka bërë verifikimin,regjistrimin dhe vlerësimin e 20% të pronave të tatueshme Ligji Nr.06/L-005.

-Zyra e TP ka hartuar planin vjetorë për verifikimin e 20% e pronave të regjistruara Ligji Nr.06/L-005.

-Zyra e tatimit në pronë për obliguesit tatimor ka përgaditur 5,287 fatura për vitin 2019 ,nga të cilat ka planifikuar që 20% e tyre të bëjë verifikimin e këtyre pronave për të përmbushur obligimin në bazë të Logjit Nr.06/L-005 e që i bie të bëjë verifikimin e 1,057 pronave. Gjat kësaj periudhe kjo zyre ka bërë verifikimin e 272 pronave që e shprehur në përqindje është 25.73 % nga ajo e planifikuar.

3.-Për të u siguruar se: Kalkulimet e faturave janë të sakta dhe të shperndara me kohë.

-Përgaditja e faturave për obliguesit tatimor është bërë sipas Ligjit Nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, U.A nr.03/2011 dhe rregullorës së K.Komunal mbi tatimin në

pronë Npi – 01/313 Datë: 30.11.2018

-Gjat testimeve te kryera kemi hasur në disa gabime në perlogaritjen e faturave konkretisht me rastin e zbritjes së bazës tatimore për vlerën prej 15,000.00 € për objektet primare të banimit, kjo vlerë është zbritur në objektin me vlerë më të vogël se sa vlera zbritëse edhe pse pronari disponon edhe me pronë tjetër në vlerë më të madhe ndersa pronari nuk është deklaruar për pronen primare te banimit. Kështu që në këto raste ndryshon vlera e faturës. Nga mostrat e marrura për testim nuk kemi hasur ne gabime gjat kategorizimit të pronave, mospërputhjes së kategorive në sovstverin e TP dhe rregullores komunale siq ka ndodhur ne auditimin e fundit për te cilat është dhënë rekomandim i cili konsiderohet i përmbushur pasi qe Komuna ka harmonizuar rregulloren me kategorizimin e pronave sipas sovstverit të TP.

-Zyra e TP për vitin 2019 ka bërë përgaditjen e 5,282 faturave për obliguesit tatimor dhe ka shpërndarë, në vlerë prej 204,263.00 €. Të gjitha faturat i janë dorëzuar PTK-së me kohë për shpërndarje dhe PTK ka këthyer raportin mbi shpërndarjen e tyre nga ky raport shihet se PTK ka shpërndar 5,098 fatura ose 96.52%. Nuk janë dorëzuar 184 fatura ,nga këto 88 adresa jo e sakt ,96 nga arsya se personat në fjalë kanë ndërruar vendbanimin. Nuk ka asnjë rast që pala është ankuar se nuk ka marrë faturen e tatimit në pronë.

4.- Shqyrtimi i ankesave te parashtruara nga tatim paguesit.

-Nga mostrat e marrura për testim del se Zyra e TP ka pranuar 291 ankesa,të gjitha ankesat kanë të bëjë me TP për tokë-parcelat,po thuaj se të gjitha ankesat kanë qenë lidhur me vlerësimin e këtyre pronave –parcelave të cilat jane të mbivlerësuara .Ndersa për TP për objektet nuk ka pasur asnjë ankesë.

5.- Për të siguruar se grumbullimi i të hyrave TP është realizuar sipas buxhetit të planifikuar.

-Komuna e Shtimes ka planifikuar (faturuar)që të hyrat vetanake nga TP për vitin 2019 të jenë në vlerë prej 136,636.83 € për objekte,ndersa për për parcela 67,626.17 Gjithësejt 204,263.00.

-Të hyrat e faturuara për vitin 2019 kanë qenë 204,263.00 € ndersa ato të inkasuara për periudhen fiskala prej 01.01 deri me 31.08.2019 kanë qenë 118,867.78 €,apo e shprehur në përqindje 58.19 % ,por në këtë inkasim hynë edhe pagesat e borgjeve të vjetra.Nga këto të hyra 63,402.66 € i takojnë borgjeve për vitin 2019 apo 53.34 % ndërsa 55,465.12 € apo 46.66 % i takojnë borxheve të vjetra nga vitet paraprake që me 31.08.2019 në total arrinë në vlerë prej 486,474.36 €. Nga ky borgj në vitin 2019 janë inkasuar 118,867.78 € ose e shprehur në përqindje 24.43 % nga borgji i përgjithshëm.

-Komuna si masë për inkasimin e këtyre borgjeve ka aplikuar dhënjen e vërtetimeve me rastin e kryerjes së disa shërbimeve si regjistrimi i pronave ,regjistrimi i vetuarave etj.Ne gjatë testimeve nuk kemi hasur ku zyrtarët e TP të kenë dhënë vërtetime për miratimin e borgjit ndersa tatim paguesi të ketë borgj të pa përmbushur.

Rekomandimet:

Rekomandimi Nr.1

Ne rekomandojmë që në rastet kur vlera e pronës rezidenciale është më e vogël se shuma zbritëse prej 15,000.00 € pjesa e mbetur zbritëse të bëhet nga vlera e parcelës rezidenciale.

Rekomandimi Nr.2

Ne rekomandojmë që në të ardhmen Zyra e njesisë së tatimit në pronë përpos masave të ndërmarrura të ndërmerr edhe masa tjera

ligjore për detyrimin e pageses se këtyre borgjeve Ligji mbi TP Ligjit Nr. 06/L-005 , UA.08/2011.,dhe UA.09/2011

Përshkrimi i shkurt i drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):

2.OBJEKTIVAT DHE FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT

Objektivat e auditimit:

Duke u bazuar në analizat e rrezikut, të testimit të kontrollit të brendshëm në njësinë e tatimit në pronë , në pajtimin e arritur në takimet me udhëheqësin e njësisë së tatimit në pronë dhe njëheri për të siguruar se sistemi i kontrollit të brendshëm i përmbushë në mënyrë adekuate kriteret e nevojshme dhe se kjo njësi ka kapacitet të mjaftueshëm për të ofruar menaxhim të efektshëm dhe efikas kemi përcaktuar objektivat në vijim:

- 1.Për të siguruar se njësia e TP ka krijuar bazën e vlerësimit të dhënave të TP.
- 2.Për të siguruar se njësia e TP ka bërë verifikimin,regjistrimin dhe vlerësimin e 20% të pronave të tatueshme U.A.10/2011
- 3.Për të siguruar se kalkulimi i faturave dhe shërndarja janë të sakta dhe me kohë.
- 4.Për të siguruar se shqyrtimi i ankesave TP është kryer me kohë sipas legjislacionit.
- 5. Për të siguruar se grumbullimi i të hyrave TP është realizuar sipas buxhetit të planifikuar.

Fushëveprimi i auditimit:

- Njësia e tatimit në pronë
- Periudha: 01.01.2019 deri 31.08.2019

1.5 Emërtimi i auditimit: Menaxhimi i automjeteve.

Të gjeturat:

Objektivat kryesore të këtij auditimi janë përqendruar në rishikimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të menaxhimit të automjeteve dhe për të dhënë siguri të arsyeshme se:

- Procedurat e menaxhimit të automjeteve janë themeluar si duhet, konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi;
- Automjetet shfrytëzohen me autorizimin e personit përgjegjës;
- Urdhëresat e udhëtimit regjistrohen si duhet dhe me kohë;
- Ekzistojnë procedurat e barazimit të shpenzimeve të derivateve dhe kilometrave të kaluara; si dhe
- Mirëmbajtja e automjeteve është adekuate.

Testimet janë bërë në rishikimin e zbatimit të procedurave, ligjeve dhe rregulloreve në fuqi mbi menaxhimin e automjeteve. Nga ekzaminimet e bëra është vërejtur se në përgjithësi Drejtoria e Administratës ka implementuar procedurat në pajtim me legjislacionin në fuqi, por ka hapësirë për përmirësime të matutjeshme në të ardhmen. Të gjeturat tona të cilat janë dhënë në pjesën 3.1 të këtij raporti janë përmbledhur si vijon:

- Komuna ka aranzhuar procedurat për menaxhimin e automjeteve dhe ate sipas Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Pushtetit Lokal Nr. 2008/01 datë 01.02.2008, Aktvendimi i Kryetarit të Komunës për përdorimin e automjeteve zyrtare nga ana e zyrtarëve të administratës Komunale Nr.02/43 datë 13.02.2013.
- Shfrytëzimi i automjeteve zyrtare bëhet në bazë të autorizimit të drejtorit (jo gjithëherë) të drejtorisë përkatëse.

- Urdhëresat e udhëtimit plotësohen me rastin e shfrytëzimit të automjetit nënshkruhen nga ana e shfrytëzuesit të automjetit, plotësohet numri i kilometrave të kaluara.
- Urdhëresat e udhëtimit vërtetohen (jo gjithëherë) nga ana e drejtorit të drejtorisë përkatëse ose nga personi i autorizuar nga ai.
- Ekzistojnë evidence të shpenzimeve të sasisë së derivateve të shpenzuara dhe kilometrave të kaluara.
- Komuna ka një servisë të kontraktuar për mirëmbajtjen e automjeteve.

Bazuar në të gjeturat tona ne kemi ardhur në konkluzionin në vijim që: sistemi i kontrollit të brendshëm i dizajnuar nga menaxhmenti në Drejtorin e Administratës në përgjithësi i përmbush nevojat për sigurimin e funksionimit të sistemit por ka hapsirë për përmirsim të më tutjeshëm në:

- Shfrytëzimi i automjeteve zyrtare bëhet në bazë të autorizimit të drejtorit të drejtorisë përkatëse. Për aq sa kemi testuar lëndet ne kemi vërejtur se janë zbatuar procedurat ligjore në secilen faz të përdorimit të automjetit, por jo gjithë herë janë aprovuar formalisht me fletë dalje autorizimet për udhetime zyrtare nga menaxhmenti-mungojnë fletëdaljet.
- Zyrtari autorizues për aprovimin e udhëtimit zakonisht është drejtori dhe përgjegjësit e sektorit të cilët edhe miratojnë kërkesat nga stafi për udhëtim zyrtar. Komuna ka përgjegjësin e parkut të automjeteve i cili edhe autorizon dhënjën e veturës në përdorim për udhtimin e stafit. Përdorimi i automjeteve për udhetime zyrtare mbështetet me dokumentacion siq janë:
 - Urdhëresat e udhëtimit që plotësohen me rastin e shfrytëzimit të automjetit nënshkruhen nga ana e shfrytëzuesit të automjetit por jo gjithë herë plotësohet në mënyrë të rregullt dhe të plotë. Kemi rastë kur nuk ka fletëdalje (miratim paraprak) për udhetime zyrtare, nuk kemi të përshkruar (arsyetuar) punën apo detyrën zyrtare për të cilën është shfrytëzuar automjeti.
- Egzistojnë evidence të shpenzimeve të karburantit dhe km të kaluara sipas automjeteve të shfrytëzuara. Mirpo nuk është bërë testimi i normës së shpenzimeve të karburanteve për 100 km të kalura për çdo automjet nga një komision i caktuar apo autoritet ligjor. Tabelat në vazhdim tregojnë sasinë e karburantit të hargjuar si dhe vlerimin për km:

Nr.re	Data e rexhistrimit të KM	Automjeti	Shfrytëzuesi	Lloji i karburantit	Sasia	Km.e kaluara	Shp.për 100 Km	Vlera në €
1	12.09.2019	Pasat 05Z-01-22	Kryetari	Dizell	1,003.00	14,059	7.13	1,064.00
2	05.09.2019	Toyota 05-03-22	Administrata e përgjithshme	Dizell	436.00	4,001	10.90	463.98
3	04.09.2019	Golf V 05Z-04-22	Administrata e përgjithshme	Dizell	712.00	11,026	6.46	757.15
4	11.09.2019	Golf V 05Z-05-22	Administrata e përgjithshme	Dizell	838.00	12,569	6.67	890.57
5	10.09.2019	Golf V 05-06-22	Administrata e përgjithshme	Dizell	485.00	8,790	5.52	512.25
6	05.09.2019	Toyota 05-07-22	Administrata e përgjithshme	Dizell	668.00	7,958	8.39	708.10
7	06.09.2019	Toyota 05Z-09-22	Administrata e përgjithshme	Dizell	674.00	6,202	10.87	715.04
8	02.09.2019	Suzuki 05-10-22	Administrata e përgjithshme	Dizell	180.00	1,765	10.20	191.99
Totali:					4,996.00	66,370	7.53	5,303.08

Për automjetet kryhen servisimet obligative dhe sezonal, si dhe mirëmbajtjet e vazhdueshme.

- Komuna ka një servisë të kontraktuar për mirëmbajtjen e automjeteve.

Rekomandimet:

Rekomandimi Nr.1.

Me rastin e shfrytëzimit të veturave nga ana e stafit për kryerjen e punëve zyrtare të plotësohen urdhëresat e udhëtimit plotësisht, të ketë autorizimin nga menaxheri përkatës me fletëdlje, që të vertetohet qëllimi i udhëtimit zyrtar dhe të përshkruhet detyra zyrtare për atë udhëtim.

Përshkrimi i shkurt i drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):

-Objektivat e auditimit:

Në bazë të analizës së rrezikut të sistemit të kontrollit të brendshëm në Drejtorin e Administratës dhe në pajtim me marrëveshjen e arritur me menaxhmentin gjatë takimit fillestar më 07.10.2019, objektivat tona të auditimit janë që:

1. Procedurat e menaxhimit të automjeteve janë themeluar si duhet, konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.
2. Automjetet shfrytëzohen me autorizimin e personit përgjegjës
3. Urdhëresat e udhëtimit regjistrohen si duhet dhe me kohë.
4. Ekzistojnë procedurat e barazimit-evidenca të shpenzimeve të derivateve dhe kilometrave të kaluara.

Mirëmbajtja e automjeteve është adekuate

-Fushëveprimi i auditimit

-Rishikimi i menaxhimit të automjeteve zyrtare të Komunes për vitin 2018.

1.6 Emërtimi i auditimit: Të hyrat vetanake në Drejtorinë për planifikim urban, kadastër dhe gjeodezi.

Të gjeturat:

-Ekzistojnë procedurat për krijimin dhe menaxhimin e të hyrave vetanake .

-Procedurat e krijimit të të hyrave vetanake janë themeluar si duhet dhe konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi;

-Komuna gjegjësisht Drejtoria për planifikim urban, kadastër dhe gjeodezi me rastin e hartimit dhe aprovimit të buxhetit për vitin 2019 ka planifikuar që të hyrat vetanake për vitin 2019 të jenë në vlerë prej **107,000.00 €**.

-Të hyrat e realizuara për periudhën Janar-Nëntor kanë qenë **92,511.22 €** ose **86.46 %** krahasuar me panifikimin vjetor. Ndërsa të hyrat e realizuara në raport me planifikimin periodik për këtë periudhë (**01.01.2019 deri më 30.11.2019**) janë realizuar **94.32 %**.

Duke u bazuar në testimet e kryera kemi konstatuar se ky realizim i të hyrave është mjaft i suksesshëm edhe pse në dukje le pershtypjen se është më i ulët në % krahasuar me realizimin me vitin nga auditimi paraprak i të hyrave i cili ishte 124.46%, por është jo real sepse gjatë asaj kohe ka pasur të hyra të njëtrajtshme e që ishin dominante në strukturën e këtyre të hyrave të pa planifikuara (të hyrat nga shpronësimet nga MTI) në vlerë prej 146,865 €. Duke marrë parasysh këtë fakt atëherë del se raporti në mes të të hyrave të planifikuara dhe të realizuara ndryshon rrënjësisht, që do të thotë se të hyrat e inkasuara për atë vit paraprak kanë qenë 42,311.35 € ose 27.84 %.

-Pagesat për të hyrat nga shërbimet kryhen përmes dy formave të pagesave:

a) Pagesat deri në 10 € kryhen në Komunë te zërtari-ja ku pala e marrë shërbimin .

b) Pagesat mbi 10 € kryhen në bankën komerciale Rregullorja financiare Nr.03/2010.

-Të hyrat e inkasuara janë të evidentuara në tri nivele :

1. Te Arka kryesore;

2. Te zyretarët në Drejtori nëpër sektore ;


3. Te zyrtari-ja për të hyra në nivel në SIMFK.

-Zyrtari-ja në fund të orarit të punës parat e inkasuara i dorëzon te arkatari i të hyrave.


-Arkatar i të hyrave pas përfundimit të orarit të punës bënë zbrazjen ditore të arkës duke

i dorëzuar paratë në bankën komerciale, për çdo ditë. -Në përgjithësi krijimi i të hyrave vetanake është në harmoni me ligjet, udhëzimet administrative dhe rregulloret në fuqi. Ka evidencë të qartë të procedurave dhe sistemit të inkasimit të të hyrave deri te dorëzimi i parave në bankë. -Me rastin e testimave në objektivin tonë për barazimet kemi konstatuar se kryhen barazimet në mes të evidencës së zyrtares së të hyrave Komunale dhe zyrëtarëve të thesarit, por jo edhe nëpër sektore të caktuara të Drejtorisë; Në sektorin e Urbanizmit kryhet barazimi i të hyrave përmes bankës si dhe të hyrave përmes Arkës, si dhe me zyrtaren e të hyrave. Ndërsa barazimi në sektorin e gjeodezisë dhe kadastrit ky barazim kryhet vetëm për të hyrat nga Banka me zyrtaren e të hyrave, por jo edhe nga Arka. Ky barazim nuk bëhet në mes të zyrtares së të hyrave dhe arkatares së Arkës kryesore, barazim që është i obliguar sipas rregullores 03/2010 neni 13 pika 3.
Rekomandimet: Ne rekomandojmë menaxhmentin që në të ardhmen me qëllim të zvoglimit të rrezikut dhe shtimit të kontrollit të kryej barazimin e të hyrave në afate kohore të parapara sipas Rregullores financiare 03/210 dhe të evitoj gabimet eventuale të hasura dhe të bëjë përmirësimin e tyre me kohë, e sidomos barazimi në mes të zyrtarit të të hyrave dhe arkatarit të inksimit të të hyrave, rregullorja financiare nr. 03/2010 neni 13 pika 3.
Përshkrim i shkurtër i drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit): -Objektivat kryesore të këtijë auditimi janë për të siguruar se: 1. Procedurat e krijimit të të hyrave janë themeluar si duhet dhe konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi. 2. Të hyrat realizohen sipas planifikimit të buxhetit për vitin aktual . 3. Për të siguruar se pagesat e kryera regjistrohen si duhet dhe me kohë. 4. Që të ketë procedura të barazimit ,të ketë gjurmë,dhe janë të miratuara nga niveli i duhur imenaxhmentit. 5. Të ipen rekomandime për përmirësim nëse ka nevojë dhe për të siguruar se është arritë marrëveshje për to. - Fushëveprimi i auditimit Drejtoria për planifikim urban,kadastër dhe gjeodezi. -Periudha: 01.01.2019 deri 30.11.2019
1.7 Emërtimi i Auditimit:
Të gjeturat:
Rekomandimet:
Përshkrim i shkurt i drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):
1.8 Emërtimi i auditimit:
Te gjeturat:
Rekomandimet:
Përshkrimi i shkurt i drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):

1.9 Emërtimi i auditimit:
Të gjeturat:
Rekomandimet:
Përshkrimi i shkurt i drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):
1.10 Emërtimi i auditimit:
Të gjeturat:
Rekomandimet:
Përshkrimi i shkurt i drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):
2. Rastet e moszbatimit ose zbatimit të gabuar të ligjit dhe dispozitave tjera ligjore, dhe dyshimeve për mashtrim
2.1 Thekso shkurtimisht rastet e mos përmbajtjes ose zbatimit të gabuar të ligjeve dhe dispozitave tjera dhe dyshimit të mashtrimit të vërtetuara gjatë kryerjes së auditimit:
3. Aktivitetet të cilat i ka ndërmarrë Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik me qëllim të zbatimit të rekomandimeve të rëndësishme, si dhe moszbatimin e rekomandimeve të rëndësishme
3.1 Shkurtimisht thekso aktivitetet e rëndësishme të cilat i ka ndërmarrë Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik me qëllim të zbatimit të rekomandimeve nga raportet e auditimit:
3.2 Shkurtimisht përshkruaj rekomandimet e rëndësishme nga raportet e auditimit të cilat nuk janë zbatuar:
4. Përfundimet kryesore të cilat kanë të bëjnë me funksionimin e sistemit financiar dhe të kontrollit, si dhe rekomandimet e dhëna me qëllim të përmirësimit të afarizmit të subjektit të sektorit publik
5. Propozimet për zhvillimin e auditimit të brendshëm
5.1 Theksoni shkurtimisht aktivitetet të cilat janë planifikuar ose janë realizuar për zhvillimin e auditimit të brendshëm në subjektin tuaj të sektorit publik:
5.2 Propozimet e juaja për zhvillim dhe përparim të auditimit të brendshëm (në përgjithësi)
Komentet:


(Nënshkrimi i udhëheqësit të NjAB)




(Nënshkrimi i Udhëheqësit të SSP)